

Vendim nr. 83 datë 24.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 24.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (S) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **SKËNDER FRASHËRI, EJVIS NUESSEIN (FRASHËRI)**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1413, datë 10.04.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-2040, datë 21.09.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”; ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi R.F. ka pasur cilësinë e palës paditëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar si trashëgimtar i trashëgimlënës N.V.(F.), sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. 861, datë 03.08.1993.

2. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës” (ligji nr. 9235/2004), R.F., trashëgimtari i vetëm i subjektit të shpronësuar N.V.(F.), i është drejtuar me kërkesë ish-Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë për “Njohjen, Kthimin apo Kompensimin e një sipërfaqeje kullosore prej 625.000 m² të ndodhur në territorin e Komunës Novoselë Vlorë”, e cila rezultonte e regjistruar në regjistrat hipotekorë të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Vlorë.

3. Me vendimin nr. 399, datë 25.11.2008, Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Qarku (ZRKKP), Vlorë ka vendosur: *“a. Të njohë të drejtën e pronësisë për sipërfaqen prej 625.000 m² kullotë të ndodhur në territorin e Komunës Novoselë, Vlorë me kufij: V – Terren i lirë (ish pronë e vet); J – Udhë; L – Terren i lirë; Vjosa e vjetër; P – Ana e Detit, trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar N.V. sipas dëshmisë së trashëgimisë akt noterial nr. 861, datë 03.08.1993. b. Të kthejë në natyrë sipërfaqen prej 625000 m² kullotë të ndodhur në territorin e komunës Novoselë, Vlorë me kufij: V – Terren i lirë (ish pronë e vet); J – Udhë; L – Terren i lirë, Vjosa e Vjetër; P – Ana e Detit, trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar N.V. sipas dëshmisë së trashëgimisë akt – noterial nr. 861, datë 03.08.1993. c. Këtij vendimi i bashkëngjitet planvendosja sipas shenjave konvencionale përkatëse dhe proces verbali i dorëzimit të pronës.”.*

4. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar të drejtën e shqyrtimit me iniciativën e tij drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), Tiranë, i cili, me vendimin nr. 4484/8, datë 22.06.2009, ka vendosur: *“a. Shfuqizimin e vendimit nr. 399, datë 25.11.2008 dhënë nga ZRKKP Qarku Vlorë. b. Kthimin për rishqyrtim në ZRKKP Qarku Vlorë të vendimit nr. 399, datë 25.11.2008, duke lënë si detyrë: Të kryhet një hetim administrativ dhe një analizë më e plotë dhe e thelluar në lidhje me dokumentin e origjinës së pronësisë së pronës së pretenduar, ku të sqarohen të gjitha problemet e konstatuara më lart. Të plotësohet dokumentacioni hartografik i mëparshëm dhe aktual në përputhje me kriteret që parashikon VKM-ja nr. 747, datë 09.11.2006 “Për procedurat e mbledhjes, të përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar”, të pozicionohet prona në përputhje me kufijtë e vjetër dhe aktual si dhe më pas të kryhet një analizë më e detajuar për sa i përket pozicionimit gjeografik*

të pronës së pretenduar. Gjithashtu kjo zyrë duhet të kryejë konfirmime më të thelluara në institucionet e treta, ku të merret një informacion më i saktë në lidhje me gjendjen juridike dhe kadastrale të pronës së pretenduar.”.

5. Me vendimin nr. 127, datë 23.06.2009, ZRKKP-ja e qarkut Vlorë ka vendosur: 1. Të njohë të drejtën e pronësisë të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Sh.V., sipas dëshmive të trashëgimisë, vendimit nr. 2007, datë 28.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vendimit nr. 1002, datë 18.05.1995 të Gjykatës së Rrethit Elbasan, vendimit nr. 1002 datë 18.05.1995 të Gjykatës së Rrethit Elbasan, vendim nr. 5381, datë 28.09.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 6448 datë 20.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një sipërfaqe të përgjithshme prej 494, 6 ha tokë, e cila përbëhet nga 277, 1356 ha tokë bujqësore dhe 217, 4644 ha tokë kullotë, pyll dhe tokë djerrë të ndodhura në vendin “gryka pishë” komuna Novoselë Vlorë. 2. Ti kthejë në natyrë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Sh.V. sipërfaqen prej 100 ha tokë bujqësore e cila rezulton e lirë, e pandarë sipas ligjit 7501 datë 19.07.1991 “për tokën” me kufij V-Lumi Vjosë i Vjetër, L- parcelat me nr. 95/10, 96/7, 96/8, 127/7, 136/12, 137/6, 138/9, 188/8, 196/8, Lumi Vjosë i Vjetër, J-parcela 197/1-24, pjesërisht Pyll dhe kullotë e tij, P – Lumi Vjosa i vjetër. 3. Ti kthejë në natyrë trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar Sh.V. sipërfaqen prej 217, 4644 ha tokë kullotë, pyll dhe tokë djerrë e ndodhur në vendin e quajtur gryka Pishë në komunën Novoselë Vlorë nga e cila: 49.4344 ha kullotë, pyll, tokë djerrë përfshihet brenda hartave të menaxhimit të pasurive në shkallë 1:2500 dhe përbëhet nga parcelat [...].

6. Po kështu, me vendimin nr. 1430, datë 27.12.2011, AKKP-ja, Tiranë ka vendosur mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për pronën me sipërfaqe prej 625.000 m² të ndodhur në vendin “Gryka”, komuna Novoselë, Vlorë. Në referim të dokumentacionit hartografik nga ana e AKPP-së, Tiranë është arritur në konkluzionin se kërkesa e trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar N.V.(F.) nuk mund të trajtohej pozitivisht, pasi kjo pronë u është njohur me vendimin nr. 127, datë 23.06.2009 nga ish-ZRKKP-ja e qarkut Vlorë në favor të subjektit të shpronësuar Sh.V. (trashëgimtarëve ligjorë të tij), i cili është bërë titull ekzekutiv për shkak të vendimit nr. 27.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

7. Paditësi R.F., në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të ish-pronares N.V.(F.), i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar anulimin e vendimit të mësipërm të AKKP-së, Tiranë, njohjen dhe kthimin e pronës, si dhe detyrimin për regjistrimin e kësaj pasurie në favor të tij,

marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke bllokuar çdo veprim juridik të mundshëm që mund të realizohej nga palët objekt gjykimi, urdhërimin e ZRPP-së për bllokimin e pronës objekt gjykimi.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12943, datë 31.12.2012, ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë së paditësit R.F. si të pabazuar në prova dhe në ligj.”*. Sipas gjykatës *“Pretendimi i paditësit për kthimin e sipërfaqes prej 62.5 ha sipas vendndodhjes reale të saj gjendet i pabazuar edhe për faktin se nuk rezulton të jetë shqyrtuar më parë në rrugë administrative nga ana e organit të caktuar me ligj për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës sikurse rezulton të jetë pala e paditur në këtë gjykim AKKP, si dhe mosnjohja e pronës sipas vendndodhjes reale të saj rezulton të ketë ardhur për faj të palës paditëse e cila në kuptim të përcaktimeve të VKM nr. 255, datë 13.04.2010 “Për Procedurat e Mbledhjes, Përpunimit dhe Administrimit të Akteve të Subjekteve të Shpronësuar, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompensimit të pronës” kishte për detyrë të poziciononte pronën sipas vendndodhjes reale të saj duke iu referuar për këtë qëllim dokumentacionit hartografik të mëparshëm dhe atij aktual. Nga vendimi nr. 127, datë 23.06.2009 i ish-Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë në kushtet kur prona e trajtuar me vendimin e sipërcituar rezulton të ketë qenë në pronësi të subjektit të shpronësuar Sh.V. dhe jo në pronësi të trashëgimlënësës së paditësit R.F., si dhe këtij të fundit nuk rezulton t’i jetë cenuar ndonjë interes i ligjshëm edhe nga kontrata e shitjes me nr. 6360 rep., nr. 2429 kol, datë 14.09.2009 lidhur ndërmjet të paditurve si trashëgimtarë të subjektit të shpronësuar Sh.V. me të paditurën D.H”*. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në gjykatën e apelit pala paditëse R.F.

9. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1413, datë 10.04.2014, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit civil nr. 12943, datë 31.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*, duke arsyetuar se *“pretendimi i paditësit për kthimin e sipërfaqes prej 62.5 ha sipas vendndodhjes reale të saj është i pabazuar për faktin se nuk rezulton të jetë shqyrtuar më parë në rrugë administrative nga ana e organit të caktuar me ligj për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës sikurse rezulton të jetë Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe mosnjohja e pronës sipas vendndodhjes reale të saj rezulton të ketë ardhur për faj të palës paditëse e cila në kuptim të përcaktimeve të VKM nr. 255, datë 13.04.2010 “Për Procedurat e Mbledhjes, Përpunimit dhe Administrimit të Akteve të Subjekteve të Shpronësuar, gjatë procesit të njohjes dhe kthimit apo kompensimit të pronës” kishte për detyrë të poziciononte pronën sipas vendndodhjes reale të saj*

duke iu referuar për këtë qëllim dokumentacionit hartografik të mëparshëm dhe atij aktual.”.
Kundër këtij vendimi pala e paditëse ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022 -2040, datë 21.09.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se konkluzionet e arritura nga gjykata e apelit janë rrjedhojë e hetimit të plotë të çështjes dhe se pretendimet në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të asaj gjykate.

11. Në datën 23.01.2023, duke qenë se trashëgimtari i subjektit të shpronësuar, që ka vënë në lëvizje gjykimin e zakonshëm, ka ndërruar jetë, trashëgimtarët ligjorë të tij (*kërkuesit*) i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

II

Pretendimet e kërkuesve

12. *Kërkuesit*, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se nga procesi gjyqësor i kundërshtuar u është cenuar:

12.1. *E drejta e ankimit dhe e drejta për t’u dëgjuar*, pasi në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë shqyrtuar të gjitha shkaqet e paraqitura në rekurs. Ajo duhej të investohej për t’i dhënë përgjigje në themel pretendimeve të kërkuesve me një vendim të arsyetuar. Ndryshimi i ligjit procedural lidhur me zhvillimin e gjykimin në Gjykatën e Lartë nuk duhet të shërbejë si arsye për pamundësimin e palëve ndërgjyqëse të dëgjoen drejtpërdrejt nga gjykata në seancë publike.

12.2. *Parimi i sigurisë juridike në drejtim të së drejtës së pronës*, pasi kërkuesve u është njohur dhe kthyer prona dhe më pas në mënyrë të paligjshme u është rimarrë, megjithëse titulli i pronësisë në origjinë pranohet që është i rregullt dhe nuk krijon mbivendosje.

12.3. *Parimi i ligjshmërisë*, pasi gjykatat nuk kanë vlerësuar fuqinë juridike të akteve të marrë nga AKKP-ja, Tiranë ndaj kërkuesve, si dhe nuk kanë zbatuar vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuësve

13. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Çdo individ, subjekt i së drejtës private, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuësit legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi janë trashëgimtarë ligjorë të palës paditëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

15. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se u është cenuar e drejta për akses dhe për t’u dëgjuar në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, e drejta e pronës, si dhe parimi i sigurisë juridike dhe ai i ligjshmërisë. Për rrjedhojë, kërkuësit kanë plotësuar edhe kriterin për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, pasi me ankimin e tyre kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga

konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuessit mban datën 21.09.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 21.01.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar). Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, pra përmbush edhe kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*.

18. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuessit kanë pretenduar, ndër të tjera, se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm u kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi edhe pse u është njohur dhe kthyer prona, më pas në mënyrë të paligjshme u është rimarrë, megjithëse titulli i pronësisë në origjinë pranohet që është i rregullt dhe nuk krijon mbivendosje. Po kështu, u është cenuar edhe parimi i ligjshmërisë, pasi gjykatat nuk kanë vlerësuar fuqinë juridike të akteve të marra nga AKKP-ja, Tiranë ndaj kërkuessve, si dhe nuk kanë zbatuar vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës.

19. Në jurisprudencën e vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr.9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimet nr. 2 datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017; nr. 6, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nisur nga sa më lart, në lidhje me pretendimin se gjykatat nuk kanë zbatuar vendimin nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës, i cili është me natyrë detyruese, Kolegji vëren se në këtë

vendim ajo ka vendosur shfuqizimin e neneve 15 pika 1, shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe 16 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës” të ndryshuar me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës” të ndryshuar”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

22. Kolegji vëren se në rastin në shqyrtim, me vendimin nr. 1430, datë 27.12.2011, AKKP-ja, Tiranë ka vendosur mosnjohjen e së drejtës së pronësisë për pronën me sipërfaqe prej 625.000 m², pasi në referim të dokumentacionit hartografik prej saj është arritur në konkluzionin se kërkesa e trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar N.V.(F.), kërkuesve në këtë gjykim, nuk mund të trajtohej pozitivisht, pasi kjo pronë u është njohur me vendimin nr. 127, datë 23.06.2009 nga ish-ZRKKP-ja e qarkut Vlorë në favor të subjektit të shpronësuar Sh.V. (trashëgimtarëve ligjorë të tij), i cili është bërë titull ekzekutiv për shkak të vendimit nr. 27.05.2010 të Gjykatës. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë se në ç’mënyrë gjen zbatim ky vendim i Gjykatës edhe pse është i detyrueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete.

23. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesve janë më tepër të natyrës ligjore, për interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga organet gjyqësore, dhe jo mbi ndonjë të drejtë të fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për të cilin mund të kishte cenim të të drejtave të fituara ose pritshmërive të ligjshme. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesve nuk është ngritur në nivel kushtetues.

24. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës së ankimit dhe së drejtës për t’u dëgjuar, duke qenë se janë me natyrë kushtetuese *prima facie* përfshihen në kompetencën e kësaj Gjykate, për rrjedhojë do të analizohen në vijim nga Kolegji.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së ankimit dhe së drejtës për t’u dëgjuar

25. Kërkuesit pretendojnë se në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk janë shqyrtuar të gjitha shkaqet e paraqitura në rekurs. Ajo duhej të investohej për t’u dhënë përgjigje në themel pretendimeve të kërkuesve me një vendim të arsyetuar. Ndryshimi i ligjit procedural lidhur me zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk duhet të shërbejë si arsye për pamundësimin e palëve ndërgjyqëse që të dëgjoen drejtpërdrejt nga gjykata në seancë publike.

26. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të

kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile /penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 24, datë 25.04.2016; nr. 6, datë 10.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues (*shih vendimin nr. 23, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr.31, datë 26.05.2014; nr. 21, datë 04.04.2016; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga ana tjetër, për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencën e saj në vijimësi, Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr.21, datë 20.03.2017; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, për vlerësimin e pranueshmërisë së shkaqeve të rekursit, i është referuar nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) sipas formulimit që ka pasur në kohën e paraqitjes së rekursit, prandaj pretendimi i kërkuarve se ndryshimi i ligjit procedural lidhur me kohën e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk duhet të shërbejë si arsye për pamundësimin e palëve ndërgjyqëse që të dëgjohen drejtpërdrejt nga gjykata në seancë publike, haptazi nuk qëndron (*shih paragrafët 18-18.1. të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

30. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi e ka shqyrtuar rekursin e kërkuarve, ka arsyetuar se rekursi i paraqitur nga paditësi R.F., është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së, pasi nuk rezultojnë që në gjykim të jenë lejuar shkelje procedurale që do ta bënin të pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave. Gjithashtu, Kolegji konstaton se gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, dhe se vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po kështu, ky Kolegj ka argumentuar se pretendimet në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të kësaj gjykate. Nëpërmjet rekursit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave (*shih paragrafët 18.1.-19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

31. Kolegji vëren se në tërësinë e tij vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Ai nuk rezultojnë të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë. Prandaj, Kolegji vlerëson se vendimi i kundërshtuar nuk cenon kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, për rrjedhojë edhe pretendimi i kërkuarve për

cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

32. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.